

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: POLICIA E KOSOVËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	214/30400-25-7580-1-1-1
Nr i brendshëm	214/24/053/111

Sa i përket tenderit për: **“FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-së-Ritender”**.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

AUTOTRADE SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR.MAGJISTRALJA PRISHTINE FERIZAJ

(Adresa)

Llapnaselle

10 052

(Vendi)

(Kodi postar)

038-600-260

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Yll Hajdari

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

INFO@AUTOTRADE-KS.COM

(Adresa elektronike)

03.04.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

Prishtinë

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 19.08.2025
Data e hapjes së ofertave dt. 30.09.2025
Njoftimi mbi vendimin e AK-së I, i dt. 07.11.2025
Kërkesa për rishqyrtim e dt.12.11.2025
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 19.11.2025
Ankesa për OSHP e dt.26.11.2025
Ekspertiza e ekspertit shqyrtues nr.2025/1157 e dt.11.12.2025
Vendimi i OSHP-së nr.2025/1157, i dt.13.02.2026
Njoftimi mbi vendimin e AK-së II, i dt.13.02.2026
Kërkesa për rishqyrtim e dt.16.03.2026
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 26.03.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Bashkangjitur keni vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 52 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
Vendimi i OSHP-së nr.2025/1157.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt. 19.08.2025, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 30.09.2025, ku kanë ofertuar 2 kompani.

Me dt. **07.11.2025** përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë Grupi i OE "AUTOBUQA" SH.P.K. & GLOBAL Teile L.L.C., ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin se çmimet me të cilat kemi ofertuar, janë çmime më të larta se sa çmimet e tregut.

Kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së të lartcekur, ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues, e cila na ishte refuzuar nga ana e AK-së, ndërsa pastaj

kemi vazhduar me ankesë në OSHP.

Në lidhje me ankesën tonë është nxjerr ekspertiza me nr.2025/1157, me dt.11.12.2025, ndërsa me dt.13.02.2026, është nxjerr edhe vendimi i panelit shqyrtues me nr.2025/1157, me të cilin vendim është aprovuar si pjesërisht e bazuar ankesa jonë, ndërsa është anuluar njoftimi i mbi vendimin e AK-së dhe lënda është kthyer në rivlerësim.

Tani pas rivlerësimit autoriteti kontraktues përsëri ka nxjerr njoftimin mbi vendimin e saj me dt.13.03.2026, ku tani e ka anuluar aktivitetin e prokurimit, ndërsa përsëri na ka eliminuar neve me arsyetimin si në vijim:

OE është i papërgjegjshëm për pikat në vijim:

OE është i papërgjegjshëm për pikat në vijim:

Komisioni I ri-vlerësimit nuk ka kërkuar sqarim në lidhje me çmimet e ofruar nga OE për arsye se këto sqarime I ka bere komisioni I vlerësimi –paraprak ,sqarimet e dhëna nga OE nuk janë bindëse as për komisionin e rivlerësimit

OE ka ofertuar çmime shumë herë me te larta se sa ato real në treg, ndaj duke ju referuar nenit 4.1 pikës C të rregullores nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik e cila thotë gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:

sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut ju keni ofruar me çmime shumë herë me te lart se sa çmimet reale të tregut, duke ju referuar ofertës financiare OE ka ofruar me çmime shumë here me te larta për artikujt e poshtë shënuar se sa vlera reale e tregut dhe vlera e planifikuara nga ana e AK e cila është caktuar duke u bazuar në hulumtim të tregut dhe në kontratën e cila është ende aktive për këtë aktivitet.

Po ashtu duke ju referuar edhe interpretimit të KRPP AK në harmoni të plot me LPP ka kërkuar sqarime gjate fazës së parë të vlerësimit mbi çmimet shumë herë me te larta se sa ato reale në treg dhe OE ka ofruar vetëm një zbrithim, program të OE por asnjë dëshmi apo dokumentim se si ka arritur deri tek formulim i këtyre çmimeve

Pjesa A: Pz.1, Pz.3, Pz.5, Pz.10, Pz.11, Pz.12, Pz.13, Pz.14, Pz.15, Pz.19, Pz.20, Pz.21,

Pjesa B: Pz.32, Pz.49, Pz.50, Pz.51, Pz.62, Pz.74, 81, Pz.83, Pz.84, Pz.88, Pz.89, Pz.101, Pz.102, Pz.105, Pz.108, Pz.109, Pz.113, Pz.114, Pz.115, Pz.116, Pz.117, Pz.118, Pz.120.

Pjesa C: Pz.121, Pz.122, Pz.123, Pz.130, Pz.133, Pz.145, Pz.149, Pz.150, Pz.152, Pz.162, Pz.163, Pz.164, Pz.165, Pz.167, Pz.172, Pz.173, Pz.174, Pz.175, Pz.180, Pz.182, Pz.183, Pz.184, Pz.185, Pz.186, Pz.187, Pz.188, Pz.189, Pz.190, Pz.191, Pz.192, Pz.193, Pz.194, Pz.195, Pz.196, Pz.204, Pz.210.

Andaj oferta juaj është e papërgjegjshme.

Arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë ashtu siç edhe e kemi cekur edhe në kërkesën e kaluar për rishqyrtim dhe ankesën e dorëzuar në OSHP, është i paqëndrueshëm për faktin se ne i kemi dhënë sqarimet e kërkuara autoritetit kontraktues, ku e kemi vërtetuar se çmimet me të cilat kemi ofertuar ne janë çmime të tregut.

Në përgjigjen tonë e kemi sqaruar se: *Për të ju deshmuar se POLICIA E KOSOVËS, është klient ekskluziv dhe se gjithmonë merr zbritjet më të mira në treg, për të gjitha pikat e kërkuara, ju kemi bashkangjitur cmimet të cilat janë në sistemet e TOYOTA, si dhe cmimet të cilat ju janë ofruar me zbritje për POLICINE E KOSOVËS. Në rast se dëshironi cmime krahasuese, dhe hulumtimi të jetë sa më i sakte dhe më i drejtë, ju preferojmë të dërgoni kërkesë tek perfaqësuesi i Toyota për pjesë origjinale kudo në rajon apo në botë për pjesët dhe do të vërtetoheni që cmimet e ofruara janë më të lira/ulëta.*

Prandaj ne nuk e kemi të qartë se si ka ardh në përfundim AK-ja se çmimet tona janë më të larta se çmimet e tregut, përderisa çmimet janë dhënë nga prodhuesi ndërsa ne kemi bërë edhe zbritje për autoritetin kontraktues. Njëkohësisht ne kemi ofertuar brenda vlerës së parashikuar, andaj arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm, sepse në rast se ka pasur ende dilema ka mundur të kërkoj sqarime shtesë nga ana e prodhuesit tonë.

Në lidhje me këtë arsye të eliminimit sqarojmë se nuk ka bazë ligjore dhe nuk ka asnjë mbështetje faktike për shkak se ne me sqarime i kemi ofruar në detaje çmimet e prodhuesit për pajisje origjinale dhe zbritjet të cilat na janë ofruar neve. AK-ja vetëm e cek që kemi ofruar Çmime më të larta se sa çmimet e tregut, mirëpo nuk ka dhënë asnjë argument apo dëshmi se cilat janë çmimet e tregut, prandaj mbi këtë bazë rezulton se arsyeja e eliminimit është e pa bazuar dhe e pa mbështetur në ndonjë dëshmi konkrete por kjo arsye mbetet vetëm në kuadër të supozimeve të AK-së. Në treg mund të ketë eventualisht çmime më të lira se sa oferta jonë por ato çmime mund të jenë për pjesë jo origjinale, ndërsa për pjesët origjinale të Toyota nuk ka asnjë mundësi të ketë çmime më të lira se sa oferta jonë. Pa një analizë të çmimeve të tregut nuk mund të eliminohehi nga konkurrenca dhe atë pa një analizë të mirëfilltë, sepse analiza e çmimeve të tregut nuk mund të jetë krahasuese nëse analizohen çmimet e pjesëve jo origjinale me çmimin e pjesëve origjinale.

Referimi i AK-së në nenin 4.1 pika C të Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 nuk përkon me rastin konkret sepse nuk ka asnjë dëshmi që është siguruar autoriteti kontraktues se çmimi i ofruar nga ne është jashtë çmimeve të tregut, prandaj arsyeja e eliminimit është e pa bazuar.

Përkundrazi ne e kemi sqaruar dhe dëshmuar se çmimi i ofruar nga ne është çmim real i tregut, ndërsa nëse AK-së ka pasur vullnet për të vërtetuar këtë fakt shumë lehtë ka mundur të verifikojë çmimin tonë duke kërkuar sqarim edhe nga prodhuesi kudo në Evropë apo rajon, mirëpo një vullnet i tillë ka munguar e që neve na bënë të dyshojmë se veprimet e AK-së janë tendencioze në raport me kompaninë tonë.

AK-ja vet e ka pranuar se tani me rastin e rivlerësimit nuk janë kërkuar sqarime fare, për shkak se janë kërkuar sqarimet në vlerësimin paraprak, pra AK-ja nuk ka shfrytëzuar në mënyrë të drejtë nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, pasi që nuk ka kërkuar sqarime direkt nga prodhuesi.

Duhet cekur fakti se sqarimet e prezantuara nga ana jonë e tregojnë qartë se ne jemi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa faktin se sqarimet tona janë në harmoni me dispozitat ligjore e ka vërtetuar edhe paneli shqyrtues i OSHP-së.

Paneli shqyrtues i OSHP-së në vendimin e saj nr.2025/1157, ka konstatuar si në vijim:

Ankuesi lidhur me pretendimin ankimor lidhur me arsyen e eliminimit sa i perket sqarimeve te ofruara edhe sipas kërkesës per sqarime te cilat pretendon se me date 24.10.2025 ka kthyer përgjigjet e nevojshme, PSH lidhur me kete pretendim ankimor nuk ia fal besimin përgjigjes se dhënë ekspertit shqyrtues, rrjedhimisht PSH konstaton se përgjigjet e dhëna nga ana e OE ankues janë konform dispozitave ligjore (...neni...) e kete rast AK nuk ka vepruar ne zbatim te dispozitës ligjore te nenit 61 par.4 i LPP-se per shkak se nuk kemi te bejme me çmime jo normalisht te ulëta ngase për t'u plotësuar ky kusht ne zbatim te interpretimeve te KRPP-se , duhet te vleresohen se paku tre (3) OE te përgjegjshëm ne një aktivitet te prokurimit, qe në këtë rast nuk është plotësuar.

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se autoriteti kontraktues përveç faktit që na ka diskriminuar neve si OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, i njëjti nuk ka respektuar edhe vendimin e OSHP-së, ndërsa në këtë rast konsiderojmë që kemi të bëjmë me një mos zbatim të vendimit të OSHP-së dhe shpërfillje të vendimit të OSHP-së, prandaj ky veprim bënë pjesë në shkelje të rënda sipas nenit 97.1 pika (h) të RRPP Nr.001/2022. Në këtë rast kemi shkelje edhe të nenit 131 të LPP-së.

Ne me dt.26.03.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që autoriteti kontraktues në asnjë mënyrë nuk ka dhënë ndonjë arsye konkrete për një refuzim të tillë.

Autoriteti kontraktues në arsyetimin e saj ka bërë përsëritje apo përshtkrim të dispozitave

ligjore, duke e theksuar se ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore. Ndërsa në lidhje me pretendimin tonë ankimor sa i përket arsyes së eliminimit tonë, e njëjta është thirr në një kontratë të mëhershme përkatësisht të vitit 2023, të cilën ne si OE e kemi nënshkruar me po këtë autoritet kontraktues.

Nga arsyetimi i AK-së, shihet qartë se e njëjta nuk ka bërë një analizë reale të çmimeve të tregut, por ka bërë vetëm një krahasim të disa artikujve të ofertës sonë me çmimet e një kontrate të mëhershme të realizuar nga ana jonë si operator ekonomik, e të nënshkruar në vitin 2023. Në këtë rast autoriteti kontraktues ka vepruar në mënyrë diskriminuese për shkak se një kontratë e kaluar përkatësisht e lidhur në vitin 2023 nuk mund të merret si dëshmi e çmimeve aktuale dhe referente të tregut.

Autoritetit kontraktues në arsyetimin e saj e ka cekur se:

**Këtë vlerë të parashikuar AK e ka të bazuar në kontratën të cilën e ka realizuar po me të njëjtin OE dhe e cila ka qenë aktive deri në datën 05.09.2026.
OE ka ofruar me rritje këto çmime nga 28.18 % deri në 403.11 % të cilat i kemi pasqyruar në tabelën në vazhdim.**

Ky arsyetim i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm për faktin se kontrata të cilës i referohet është kontratë e vitit 2023, e ku vlera e parashikuar në këtë aktivitet të prokurimit kishte qenë 170,000.00 euro, ndërsa tani në këtë aktivitet të prokurimit në të cilin ne jemi eliminuar, ka vlerën e parashikuar prej 400,000.00 euro.

Autoriteti kontraktues është duke u munduar të zhvendos vëmendjen nga vlera e parashikuar dhe fakti se ne kemi ofertuar brenda vlerës së parashikuar, tek kontrata e cila është nënshkruar para tri viteve, mirëpo ky veprim i AK-së është kundërligjor dhe nuk duhet të merret parasysh sepse edhe tek përgatitja e vlerës së parashikuar si element bazë merret çmimi i tregut.

Sa për sqarim, përderisa për të njëjtat produkte, në kontratën paraprake të cilës i është referuar AK-ja, vlera e parashikuar ka qenë 170,000.00 euro, ndërsa në këtë aktivitet AK-ja ka përcaktuar vlerë të parashikuar 400,000.00 euro, atëherë ky fakt tregon qartë se vetë autoriteti kontraktues nuk i është referuar kontratës paraprake si bazë për përcaktimin e çmimeve në këtë procedurë. Në rast se AK-ja do të referohej asaj kontrate, atëherë e njëjta nuk do ta rriste vlerën e parashikuar nga 170,000.00 euro në 400,000.00 euro. Prandaj ky arsyetim është kontradiktor, pasi që vet AK-ja nuk e ka përdorur kontratën paraprake si standard për caktimin e vlerës së parashikuar, por të njëjtën po e përdor si bazë kryesore për eliminimin tonë.

Ky veprim i AK-së tregon qartë se eliminimi ynë është bërë në mënyrë tendencioze, të pabazuar dhe në kundërshtim me vetë planifikimin e vlerës së parashikuar nga AK-ja.

Përderisa vetë autoriteti kontraktues, gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar për këtë aktivitet, nuk e ka marrë për bazë kontratën paraprake si standard gjë që vërtetohet nga fakti se vlera e parashikuar është rritur nga 170,000.00 euro në 400,000.00 euro, atëherë shtrohet pyetja se si mund ta përdorë të njëjtën kontratë si bazë kryesore për eliminimin e OE-së me pretendimin se çmimet janë shumë më të larta se sa çmimet e tregut.

Çmimet tona janë çmime të bazuara tek prodhuesi dhe këtë fakt, AK-së mund ta vërtetojë nëse ka interes.

Prandaj edhe një herë po e sqarojmë se përderisa vetë AK-ja ka vlerësuar se për të njëjtat produkte sikurse në aktivitetin të cilit i është referuar e njëjta, është e nevojshme të përcaktohet vlera e parashikuar prej 400,000.00 euro, atëherë nuk mund dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të eliminohemi me një arsyetim se oferta jonë është e papranueshme vetëm pse është më e lartë se çmimet e kontratës paraprake.

AK-ja në arsyetimin e saj në mënyrë tendencioze nuk e ka përmendur fare faktin se kontrata të cilës i është referuar është nënshkruar në vitin 2023, por ka përmend vetëm vitin 2026 si vit të përfundimit të saj, ku me këtë rast e njëjta krijon përshtypjen e gabuar me qëllim që ta vë në lajthitje OSHP, kinse çmimet e asaj kontrate janë aktuale dhe të krahasueshme me periudhën e tanishme. Në realitet, çmimet referente janë ato të momentit kur është zhvilluar procedura e prokurimit, e jo data e përfundimit të kontratës. Për këtë arsye, kjo mënyrë e veprimit lë

përshtypjen e qartë se AK po tenton ta vë në lajthitje edhe OSHP-në, duke mos e paraqitur një pasqyrë të saktë të krahasimit të çmimeve.

Madje, hipotetakisht edhe po të merreshin çmimet e kontratës së kaluar, si vlerë referente, ky fakt nuk do të përkonte me realitetin e sotëm sepse çmimet e të gjitha produkteve vazhdimisht janë ngritur, ku secili prej nesh jemi dëshmitar të këtij realiteti.

Kur kemi parasysh faktet e lartcekura, kuptohet qartë se autoriteti kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim, pa ndonjë bazë ligjore dhe në kundërshtim me vendimin e OSHP-së nr. 2025/1157, ku me të cilin vendim na ishte aprovuar ankesa jonë si e bazuar edhe përkundër faktit që ne ishim eliminuar nga AK-ja për arsyen e njëjtë sikurse tani. Pra çështja e çmimeve me të cilat kemi ofertuar ne është çështje e cila është shqyrtuar dhe e njëjta duhet të cilësohet si res judicata konform nenit 105 të LPP-së, paragrafi 2.16.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Po ashtu anulimi i këtij tenderi është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43.5 dhe 43.7 të RRPP Nr.001/2022, sepse nuk janë përmbushur asnjëra prej kushteve të përcaktuara në këto dispozita.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*, mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, sepse na ka eliminuar pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë dëshmi konkrete, prandaj ky është diskriminim i hapur.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **AUTOTRADE SH.P.K.**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurat ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*